



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Datë: 15.10.2021

**THIRRJE PËR SHPREHJE INTERESI
PËR LICENCIMIN E OPERATORËVE EKONOMIK PËR ORGANIZIMIN E
TRANSPORTIT TAKSI TË UDHËTARËVE ME VETURA ELEKTRIKE**

Si pjesë e strategjisë së gjelbër për nxitjen e makinave elektrike në Qytetin e Prishtinës, (Plani i Veprimit për Qytet të Gjelbër (PVQGJ) dhe Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban) me propozimin e Kryetarit të Komunës, (si dhe bazuar në Rregulloren për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve nr. 344-3707) Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, e Komunës së Prishtinës shpall këtë kërkesë për shprehje interesi për licencimin e personave juridik/operatorëve ekonomik, për organizimin e transportit taksi të udhëtarëve me vetura elektrike.

Personat juridik të cilët shprehin interesin për tu pajisur me licenca për organizimin e transportit taksi të udhëtarëve me vetura elektrike duhet të paraqesin shprehjen e interesit duke i bashkangjitur këto dëshmi:

- **Një përshkrim i shkurtër i kompanisë (maksimumi 2 faqe)**
- **Të jetë i regjistruar si person juridik në ARBK**
- **Të ketë selinë në territorin e Komunës së Prishtinës**
- **Të dorëzoj planin e financimit për veturat elektrike**
- **Të dorëzoj propozimin për vendqëndrim/parking, ku do të qëndrojnë veturat elektrike**
- **Të dorëzoj propozimin për vendosjen e dy stacioneve për mbushje elektrike të veturave – të specifikoj llojin e tyre**

Shprehja e Interesit së bashku me dokumentet e lartshënuara duhet të dorëzohet në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës, kati përdhese, sporteli nr.1 (për Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm)

Afati për të dorëzuar shprehjen e interesit është deri më datë 25.10.2021, ora 15:00h

Operatorët Ekonomik që i janë përgjigjur thirrjes për shprehje të interesit do të kenë përparësi në përzgjedhje gjatë fazës eventuale të thirrjes për aplikim